



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20 Prill 2021

Nr. 256

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj subjektit zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim,
- Kërkues:** Bashkia Roskovec
- Ndaj:** subjektit zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim
- Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, pika 2, dhe 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREJ:**

I. Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar një denoncim nga bashkia Roskovec, për shkelje të nenit 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,



të ndryshuar, udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim.

Sipas denoncimit të datës 7.4.2021, nr. 2733 prot., administruar në KQZ me nr. 3624 prot., datë 12.4.2021, pretendohet se: *“Në qytetin e Roskovecit subjekti politik Partia Demokratike ka hapur zyrë elektorale në një ambient pa njoftuar me shkrim bashkinë Roskovec.*

*Në njësinë administrative Kuman, fshati Vidhishtë subjekti politik Partia Demokratike ka hapur zyrë elektorale në një ambient privat pa njoftuar me shkrim bashkinë Roskovec, gjithashtu ka materiale propagandistike (5 flamuj) të vendosur mbi distancën e lejueshme mbi 5 m nga zyra elektorale.*

*Në njësinë administrative Kurjan, fshati Ngjeqar, subjekti politik Partia Demokratike ka hapur zyrë elektorale në një ambient privat pa njoftuar me shkrim bashkinë Roskovec.*

*Në njësinë administrative Strum, fshatrat Arapaj dhe Suk 1, subjekti politik Partia Demokratike ka hapur zyra elektorale në ambiente private pa njoftuar bashkinë Roskovec”.*

Bashkangjitur denoncimit të kërkuarit janë dorëzuar:

- Vendimi i kryetarit të bashkisë Roskovec nr. 30, datë 25.3.2021;
- Urdhri i brendshëm nr. 52, datë 31.3.2021;
- Informacioni nr. 2492/1 prot., më datë 2.4.2021, shoqëruar me foto përkatëse;
- Njoftimi i policisë bashkiake drejtuar subjektit politik Partia Demokratike, dega Roskovec;

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’a nje shprehimisht Rregullatorit apo Kas-it.

Referuar nenit 7 të ligjit nr. 10 279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, kompetenca për



konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues bashkia Roskovec, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e faktit

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më datë 23.3.2021, ka miratuar udhëzimin nr. 6 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Neni 79 i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, parashikojnë se: *“kryetari i bashkisë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore. Materialet propagandistike zgjedhore lejohen të afishohen deri në një distancë prej 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës”*.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, kryetari i bashkisë Roskovec, me vendimin nr. 30, të datës 25.3.2021, ka përcaktuar vendet për afishimin e materialeve propagandistike dhe edukative në territorin e bashkisë Roskovec për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Roskovec.

Me urdhër të brendshëm nr. 52, datë 31.3.2021 “Për verifikimin e materialeve propagandistike të afishuara nga subjektet politike, në territorin e bashkisë Roskovec”, bashkia ka urdhëruar policinë bashkiake të verifikojë hapjen e zyrave elektorale dhe afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore.

Policia bashkiake gjatë verifikimit ka konstatuar se: *“Në qytetin e Roskovecit subjekti politik Partia Demokratike ka hapur zyrë elektorale në një ambient pa njoftuar me shkrim Bashkinë Roskovec. Në njësinë administrative Kuman, fshati Vidhishtë subjekti politik Partia Demokratike ka hapur zyrë elektorale në një ambient privat pa njoftuar me shkrim bashkinë Roskovec, gjithashtu ka*



*materiale propagandistike (5 flamuj) të vendosur mbi distancën e lejueshme mbi 5 m nga zyra elektorale.*

*Në njësinë administrative Kurjan, fshati Ngjeqar, subjekti politik Partia Demokratike ka hapur zyrë elektorale në një ambient privat pa njoftuar me shkrim bashkinë Roskovec.*

*Në njësinë administrative Strum, fshatrat Arapaj dhe Suk 1, subjekti politik Partia Demokratike ka hapur zyra elektorale në ambiente private pa njoftuar bashkinë Roskovec”.*

Me shkresën nr. 2722, të datës 7.4.2021, bashkia Roskovec ka njoftuar subjektin zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim për heqjen e materialeve propagandistike, konkretisht të 5 flamujve në fshatin Vidhishtë, njësia administrative Kuman, të vendosura në një distancë më të madhe se 5 metra nga zyra elektorale, duke vendosur një afat 2 (dy) ditor nga marrja dijani e njoftimit për heqjen e tyre vullnetarisht, në kundërt policia bashkiake do të bënte të mundur heqjen e materialeve propagandistike.

Nëpërmjet personave të autorizuar prej tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka konstatuar se subjekti zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, për sa i përket afishimit të materialeve propagandistike (flamujt) janë vendosur brenda ambientit të zyrave elektorale, dhe pjesa tjetër janë vendosur nga qytetarët në banesat e tyre.

Bashkëlidhur informacionit të monitoruesit janë dorëzuar disa fotografi të zyrave elektorale, materialeve propagandistike dhe kërkesa me nr. 4 prot., datë 30.3.2021 e subjektit zgjedhor Partisë Demokratike-Aleanca për Ndryshim, drejtuar bashkisë Roskovec, për përcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore.

### III. Analiza ligjore

Neni 79, i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, përcaktojnë se: *“Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit”*



*“Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës”.*

Në referim të dokumentacionit dhe provave të dorëzuara bashkia Roskovec në të njëjtën datë me adresimin e kërkesës për subjektin zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, bashkia Roskovec ka depozituar denoncimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 3 i udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, parashikon se: *“Kryetarët e bashkive duhet të marrin masa për të mos lejuar apo të heqin menjëherë çdo material statik, përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje tjetër ku ato konstatohen që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e këtij udhëzimi”.*

Neni 5 i udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, parashikon se: *“Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhore mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve. Subjekti zgjedhor njofton me shkrim kryetarin e bashkisë përkatëse dhe vë në dijeni KQZ-në për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e sakta të tyre, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve. Administrata e bashkisë përkatëse, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike”.*

Referuar nenit 5 pika 2, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, adresat e zyrave elektorale i njoftohen me shkrim bashkisë përkatëse në mënyrë që bashkia të bëjë verifikimin nëse këto zyra janë hapur në respektim të pikës 1 të nenit 5 të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021 dhe dispozitave tjera të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike.

Referuar informacionit të dhënë nga monitoruesi është konstatuar se afishimi i materialeve propagandistike konkretisht flamujt, janë vendosur brenda ambientit të zyrave elektorale dhe pjesa tjetër janë vendosur nga qytetarët në banesat e tyre.

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve çmohet se janë hapur zyrat elektorale nga subjekti zgjedhor PD-AN, por nuk është njoftuar me shkrim bashkia Roskovec për adresat e tyre të sakta. Referuar kriterëve të



përcaktuara në nenin 5 të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, zyrat elektorale të subjektit zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim janë hapur në respektim të kufizimeve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 5 dhe të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi të gjitha provat dhe faktet në përfundim të hetimit administrativ konstaton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që të vërtetojnë shkelje të nenit 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 6 datë 23.3.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 6 datë 23.3.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

